

Parlamentet dhe normalizimi i marrëdhënieve

Hyrje

Më 8-9 tetor 2016, Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG), ka organizuar në Mavrovë të Maqedonisë tryezën e pestë të rrumbullakët për deputetë të parlamenteve të Kosovës dhe Serbisë. Deputetët kane diskutuar mënyrat se si ata mund të kontribuojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes Prishtinës e Beogradit, dhe në fuqizimin e efikasitetit dhe ndikimit të tyre në vendimmarrje.

Kjo tryezë e rrumbullakët është organizuar si pjesë një projekti më të gjërë të CIG mbi marrëdhëniet mes Beogradit dhe Prishtinës, të përkrahur nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës, dhe të implementuar në bashkëpunim me ta.

Serbia dhe Kosova kanë interesa dhe qëllime specifike për normalizimin e marrëdhënieve: Serbia shpreson ta fitojë anëtarësimin në BE dhe t'i përmirësojë marrëdhëniet politike dhe ekonomike me BE-në. Kosova, në anën tjetër, shpreson ta përfundojë procesin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, si dhe ta marrë njohjen eventuale të shtetësisë së saj nga Beogradi. Beogradi përkrah normalizimin, por e kundërshton anëtarësimin e Kosovës në organizatat kryesore ndërkombëtare, dhe thotë se nuk do ta njohë Kosovën. Ëndrra e së ardhmës evropiane është ndoshta i vetmi vizion, por edhe aty shpesh ka vetëm formë deklarative, e jo thelbësore. Në këtë kontekst të qëllimeve të kundërta, shumë pjesëmarrës kanë thënë se Prishtina dhe Beogradi duhet “ta racionalizojnë debatin, t'i artikulojnë në mënyrë racionale mundësitë e tyre, dhe ta zbusin retorikën e tyre nxitëse”.

Normalizimi mes Serbisë dhe Kosovës mbetet çështje e komplikuar edhe sipas standardeve “abnormale” të dinamikës së politikave të tyre të brendshme. Së këndejmi, normalizimi i marrëdhënieve mes partive ne qeveri dhe atyre opozitare, si në Prishtinë, ashtu edhe në Beograd, është kyç për ndërtimin e konsensusit nacional për të marrë vendime të vështira të cilat, sipas disa folësve, të gjithë e dinë se cilat janë: Serbisë do t'i duhet të heqë dorë nga Kosova, kurse Kosova do të duhet të ofrojë të drejta shtesë për serbët e Kosovës, përmes krijimit të Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë serbe. Përveç ndërtimit të konsensusit nacional, apo së paku të atij ndërpartiak, komuniteti ndërkombëtar, me theks të veçantë BE-ja, duhet të jetë thelbësisht më e angazhuar në ndërmjetësimin e një marrëveshjeje, e cila do t'i adresonte të gjitha mosmarrëveshjet. Shumë nga pjesëmarrësit kanë thënë se dialogu i Brukselit ka dhënë

rezultate të mira dhe ka ndërtuar një bazë solide për arritjen e marrëveshjes e cila duhet ta adresonte çështjen e statusit.

Përfundimet dhe rekomandimet e këtij raporti nuk janë bazuar në konsensus, por reflektojnë pikëpamjet e pjesëmarrësve të ndryshëm. Në jemi munduar të jemi sa më të saktë dhe të balancuar në përmbledhjen e diskutimeve, dhe së këndejmi kërkojmë mirëkuptimin e pjesëmarrësve idetë ose intervenimet e të cilëve mund të mos jenë përfshirë në tërësi në këtë raport të shkurtër, për përmbajtjen e të cilit CIG mban përgjegjësinë e plotë. Diskutimet janë zhvilluar nën rregullat e Chatham House.

Përfundimet dhe rekomandimet

Ky diskutim dyditor është përmbledhur në një numër përfundimesh dhe rekomandimesh, disa prej të cilave janë bazuar në konsensus, e disa të tjera, në mendimin e shumicës.

1. Mosmarrëveshja mbi statusin dhe narrativa e së kaluarës mbetin pengesa madhore për lëvizjen para drejt normalizimit dhe pajtimit gjithëpërfshirës mes dy shoqërive. Format, thelbi, dhe qëllimet e dialogut të Brukselit duhet të ristrukturohen me qëllim të përfshirjes së çështjes së statusit. Parlamentarët mund t'i inkurajojnë dhe përkrahin debatet racionale mbi të kaluarën, përfshirë edhe njohjen e krijimeve të kryera nga secila palë, dhe kështu të kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejt në procesin e pajtimit. Disa nga folësit kanë thënë se do të jetë e vështirë të bëhet përparim i dukshëm drejt pajtimit "përderisa kemi udhëheqës të cilët vetë janë të lidhur me luftërat," fakt ky i cili nuk mundëson shpjegim racional të luftës. Është propozuar që bisedimet të mbahen me qëllimin që shoqëria e Kosovës dhe ajo e Serbisë në të ardhmen të jetojnë së bashku, e jo të ndarë.
2. Normalizimi i marrëdhënieve mes partive në qeveri dhe atyre opozitare në Kosovë e Serbi është thelbësor për krijimin e një përkrahjeje nacionale për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mbetura. Shumë nga folësit kanë thënë se partitë në qeveri jo vetëm që nuk kanë bërë përpjekje për t'i përfshirë partitë opozitare në proces, por edhe i kanë mbajtur qëllimisht të painformuar në lidhje me neogociatat dhe marrëveshjet. Megjithatë, disa pjesëmarrës kanë thënë se shumë deputetë të Kosovës dhe Serbisë kanë qenë indiferent ndaj dialogut, dhe kanë bërë pak përpjekje për ta shtyer qeverinë që të raportojë më shpesh, dhe më në detaje. Disa nga folësit kanë thënë se diskutimi serioz mbi dialogun e Brukselit në parlamentin serb është temë tabu, dhe se deputetët nuk marrin kurrfarë dokumenti apo raporti zyrtar nga ana e negociatorëve. Disa nga ta kanë thënë se pak a shumë, e njëjta gjendje është edhe në parlamentin e Kosovës.
3. Njëri nga folësit ka propozuar që të formohet një grup i deputetëve nga Kosova dhe Serbia për t'i identifikuar dhe artikulluar çështjet konkrete, si dhe për të lobuar së bashku për zgjidhjen e tyre. Ky folës ka shtuar se edhe pse deputetët nuk kanë

mekanizma të drejtpërdrejt për zgjidhjen e problemeve, ata megjithatë kanë një zë të fuqishëm dhe mund të kenë ndikim në disa fusha. Një numër folësish kanë përkrahur idenë e zgjidhjes së çështjeve më specifike, si ato të cilat një numër i deputetëve kanë pasur rastin ti degjojnë në Hoçë të Madhe, gjatë një vizite në fshatrat me shumicë serbe. Por disa nga pjesëmarrësit kanë qenë skeptik në lidhje me rezultatin eventual të një grupi të tillë. Megjithatë, ata janë pajtuar që të diskutojnë më tej në lidhje me këtë propozim në takimin e rradhës.

4. Deputetët e Kosovës dhe Serbisë duhet ta bëjnë një “skanim të dialogut dhe marrëveshjeve” dhe ta përgatisin një dokument ku do t’i vendosnin disa parime, si dhe do t’i identifikonin fushat e bashkëpunimit mes Prishtinës dhe Beogradit. Me fjalë tjera, deputetët duhet të jenë më aktiv, duke ushtruar trysni të vazhdueshme tek qeveritë e tyre në mënyrë që ato t’u raportojnë atyre, e jo “vetëm të presin që zyrtarët qeveritarë të vijnë tek ta”, gjë që ndodhë shumë rrallë.
5. Deputetët duhet të ndihmojnë në ngritjen e vetedijës politike tek shoqëritë e tyre në lidhje me dialogun. Disa pjesëmarrës kanë thënë se vetëdija e publikut dhe mirëkuptimi veçse janë duke u përmirësuar. “Gjithnjë e më shumë njerëz në Serbi besojnë se çështja e Kosovës duhet zgjidhur në tërësi, kurse gjithnjë e më shumë njerëz në Kosovë përkrahin akomodimin e serbëve”. Megjithatë, deputetët mund ta përshpejtojnë procesin përmes kontakteve më të shpeshta me votuesit e tyre.
6. Serbët e Kosovë duhet të përfshihen në dialog. Disa nga folësit kanë thënë se Prishtina nuk i ka ftuar përfaqësuesit e serbëve të Kosovës që të jenë pjesë e ekipit. Serbët e Kosovës kanë qenë të përfshirë në mënyrë të tërthortë përmes ekipit të Beogradit. Një folës ka thënë se Prishtina duhet ta kuptojë se Beogradit është i rëndësishëm për serbët, jo vetëm në aspektin financiar, por edhe në atë emocional.
7. Roli i Bashkimit Evropian duhet të shkojë përtej atij të lehtësuesit “të butë”. BE-ja duhet të gjejë mënyra që edhe t’i imponojnë disa zgjidhje në fushat ku Prishtina dhe Beogradi nuk arrijnë të pajtohen. Disa folës kanë thënë se komuniteti ndërkombëtar deri më tash ka lënë anash “politikanët me sens të mendimit praktik”, dhe se punon vetëm me ata për të cilët mendon se mund të prodhojnë rezultate të menjëhershme. Por, sipas mendimit të një numri folësish, ata të cilët mund “të prodhojnë rezultate” brengosen më shumë për ruajtjen e pushtetit të tyre, se sa për zgjidhjen e problemeve.
8. Sundimi i ligjit dhe lufta e përbashkët kundër krimit të organizuar duhet të jenë në mesin e temave kryesore të cilat duhet të diskutohen në Bruksel.
9. Deputetët duhet ta konsiderojnë mundësinë e vendosjes së bashkëpunimit mes Akademive të Shkencave të Kosovës dhe Serbisë.
10. Disa nga pjesëmarrësit kanë propozuar që të organizohet një takim i përbashkët i qeverive të Kosovës dhe Serbisë.

11. Një numër i deputetëve kanë raportuar për vizitën e tyre në Hoçë të Madhe, një fshat serb me një popullsi prej rreth 700 njerëzve, ku ata kanë drekuar me rreth 15 banorë, si dhe kanë vizituar një numër biznesesh lokale. Banorët e Hoçës së Madhe u kanë thënë se fshati i tyre nuk ofron perspektivë për të rinjtë, dhe se shumica e tyre janë duke u larguar. Bizneset e vogla kanë vështirësi në gjetjen e tregjeve për t'i shitur produktet e tyre. Përveç problemeve të zakonshme ekonomike me të cilat ballafaqohen edhe komunitetet tjera (papunësia, zhvillimi i pamjaftueshëm ekonomik, plehrat, cilësia e arsimit, mungesa e barnave, etj.), ata kanë thënë se ende nuk kanë qasje në disa nga pronat e tyre private të cilat ende janë të uzurpuara nga fqinjët e tyre shqiptarë. Duke qenë se përbëjnë një numër të vogël votuesish, ata nuk ia kanë dalë të kenë përfaqësues në kuvendin komunal të komunës së tyre (Rahovec). Megjithate, disa nga banorët janë të punësuar në institucionet komunale. Banorët lokalë u kanë bërë thirrje deputetëve, e sidomos përfaqësuesve të Listës Serbe, që t'i vizitojnë më shpesh, të informohen në lidhje me problemet e tyre, dhe ti zgjidhin ato përmes mekanizmave institucional.

Në përfundim, pjesëmarrësit janë pajtuar që në takimin e rradhës ta adresojnë çështjen e personave të zhdukur, si dhe bashkëpunimin mes Odave Ekonomike të Kosovës dhe Serbisë.

Pjesëmarrësit

Balsa Bozovic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Demokratike
Sadri Ferati, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Arben Gashi, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Teuta Haxhiu, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
Enver Hoti, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, NISMA
Aleksandra Jerkov, Anëtare e Parlamentit të Serbisë, Partia Demokratike
Donika Kadaj Bujupi, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Nada Lazic, Anëtare e Parlamentit të Serbisë, Lidhja e Social Demokratëve të Vojvodinës
Snezana Paunovic, Anëtare e Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë
Nenad Rasic, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lista Serbe
Branko Ruzic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë
Armend Zemaj, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Belul Beqaj, Profesor dhe Doktor i Shkencave Politike, Prishtinë
Shpetim Gashi, Nënpresident, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Alex Roinishvili Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Philippe Guex, Ambasador i Zvicrës në Serbi dhe Mal të Zi
Arber Kuci, Përfaqësues në Kosovë, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Jean-Hubert Lebet, Ambasador i Zvicrës në Kosovë
Igor Novakovic, Përfaqësues në Serbi, Këshilli për Qeverisje Inkluzive